



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për tremujorin e dytë (TM2) 2016

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdojë të mbështesë sektorin e blegtorisë, përmes pagesave direkte për qumësht/litër dhe therrjet e raportuara të gjedhit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte - qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Kafshet duhet të jenë të identifikuara dhe regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafsheve në ferme dhe në bazen e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;
- Ta kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin qumështor të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit e AUV-së për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose piken grumbulluese të qumështit e cila është e regjistruar si biznes dhe ka kontrate me ndonjërin qumështor të licencuar, i pranueshëm është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- T'i dorëzojë më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjeren qumështore të licencuar;
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjeren qumështore të licencuar;
- Kopjen e certifikates së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopjen e kontratës së pikës grumbulluese me ndonjeren nga qumështoret e licencuara
- Dëshminë e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të dorëzuar
- Dëshminë nga AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit”;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë 0.06 €
2. Klasa e Parë 0.04 €
3. Klasa e Dytë 0.02 €

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte - therrjet e raportuara të gjedhit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara nga AUV në kategorinë A, B, dhe C;
- Të raportojnë therrjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikulluara me matrikull të Republikës së Kosovës;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit/subjektit;
- Kopjen e licencës së lëshuar nga AUV-ja;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë/vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;

- Regjistrin e kafshëve të therura, të lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit-AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së theruar;
- Dëshminë/fletëpagesën, me të cilën vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja tek fermeri, në vlerë prej **20 €/krer** gjedhe të therur.

Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa do të bëhet për krerë gjedhe të therur, në vlerë prej **30 €/krer**.
- Pagesës në vlerë prej **30 euro/krer** u bëhet thertoreve përfituese;
- Thertoret obligohen që vlerën e mjeteve prej **20 euro** t'ia paguajnë fermerit në momentin e therjes së gjedhit. Ndërsa vlera e mjeteve prej **10 euro** i mbetet thertoresh për shërbimin të therjes.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi behet ne zyrat komunale per bujqesi.

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit zgjate 30 dite kalendarike dhe fillon nga data 15.07.2016 dhe perfundon me datë 15.08.2016